



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 50
Prishtinë, më 8 shkurt 2017, në orën 14:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Elmi Reçica, Qerim Bajrami, Blerta Deliu-Kodra, Luljeta Veselaj-Gutaj, Ismet Beqiri, Pal Lekaj dhe Zafir Berisha.

Munguan: Teuta Rugova dhe Puhie Demaku.

Pjesëmarrës nga Ministria e Punëve të Jashtme: Albert Prenkaj, drejtori i përgjithshëm dhe Bashmir Xhemaj, shef i kabinetit.

Nga zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Pjesëmarrës të tjerë: Blerta Bejtullahu, EUSR/EU Office, Gurjeta Zeka, LVV, Kaltrina Beqiri, Samire Sadiku, praktikante, Gazmend Gjyshinca, GLPS, Sanije Berisha, OSBE, Vlora Nushi, UNMIK/OPA, Violeta Haxholli, Jeta Krasniqi, Eugen Cakolli, Artan Murati, KDI, Argjend Zerjnaj, GP-AAK, Andi Emini, D4D dhe media.

Mbledhjen e kryesoi: Elmi Reçica, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

Raportim i ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, z. Enver Hoxhaj, lidhur me raportet Kosovë – Serbi

Elmi Reçica, njoftoi se ministri Enver Hoxhaj është ftuar me kërkesë të deputetit Pal Lekaj, që të raportojë lidhur me raportet në mes të Kosovës dhe Serbisë. Z. Reçica shtoi se raportet Kosovë – Serbi janë përcaktuese për të ardhmen vendit dhe të rajonit, se çdo zhvillim krijon reagime dhe shqetësime, por njëkohësisht kërkon edhe sqarime. Reçica tha se ne jemi në rrjedhë të zhvillimeve që kanë ndodh, por ministri i punëve të jashtme ka qenë koherent në të gjitha zhvillimet dhe ka qenë aktiv, andaj është kërkuar që të raportojë para Komisionit.

Enver Hoxhaj, ministër i Punëve të Jashtme, tha se për Qeverinë e Republikës së Kosovës ka një vazhdimësi të politikës agresive serbe në raport me shtetin tonë dhe se kërcënues kryesor i shtetit të

Kosovës mbetet edhe më tutje Republika e Serbisë. Hoxhaj, njoftoi se me rastin e zgjedhjes si kryeministër, z. Vuçiq në fjalimin e tij në vitin 2014, ka pas vetëm 12 fjali për Kosovën, kurse në vitin 2016 pati dy faqe tekst që i kushtohen Kosovës. Në këtë platformë njoftoi Hoxhaj, përmendet “Lugina e Diellit”, përmendet një qasje e re ku Serbia kërkon dialog me shqiptarët dhe jo me Prishtinën as Kosovën, dhe se kjo është një gjuhë, të cilën e kemi pas shpeshherë në vitet e '90-ta. Të gjitha ngjarjet, provokimet, iniciativat dhe hapat që ka ndërmarr shteti serb në raport me Kosovën nuk do të duhej të shihen të izoluara, por janë pjesë e një zinxhiri të shumë skenarëve dhe ngjarjeve, të cilat janë shpërfaq në raport me Kosovën.

Ai, më tej njoftoi se në këtë platformë, po ashtu, përmendet edhe çështja e pronës publike në Kosovë. Kjo qasje e politikës serbe, tha se është paraqitë me inaugurimin e disa pompave të derivateve të filialës së operatorit MTS në veri të vendit, me ç’ rast Ministria e Tregtisë në koordinim me Ministrinë e Punëve të Jashtme ka marr vendim ta parandalojnë një akt të tillë.

Hoxhaj njoftoi se ka pasur kalim ilegal të qëllimshëm të kufirit nga zyrtarët serbë, të cilët kanë kaluar në territorin e Kosovës nëpërmjet mjeteve transportuese dhe nëpërmjet rrugëve jo të zakonshme, por atyre natyrore dhe se Policia e Kosovës dhe gjyqësia janë duke i trajtuar këto raste. Ai tha se presidenti Nikoliq ka planifikuar që të vizitojë Kosovën, ministria i ka pas informatat e plota që qëllimi i vizitës së tij ishte keqpërdorimi i festave fetare, por për shkak të agjendës së tij dhe për shkak të zhvillimeve në raport me Kosovën, është marr vendim që t’i ndalohet hyrja në Republikën e Kosovës.

Sa i përket ndërtimit të murit në Mitrovicë, ministri njoftoi se muri është ndërtuar për një natë dhe është ndërtuar përtej kompetencave dhe përgjegjësive që i ka pushteti komunal në pjesën veriore të Mitrovicës. Sa i përket arrestimit të shtetasve të Kosovës nga autoritetet e Serbisë, Hoxhaj tha se është mbajtur një seancë në Kuvendin e Kosovës ku është diskutuar kjo çështje, ndërsa sa i përket arrestimit të drejtorit të Policisë z. Nehat Thaçi dhe z. Hilmi Kelmendi, njoftoi se ka biseduar disa herë me zonjën Mogerini dhe ministrat e tjerë të jashtëm deri sa janë liruar.

Çështje tjetër, Hoxhaj tha se është keqpërdorimi i Interpolit për të përndjekur lidhshpë dhe qytetarët e Kosovës dhe për shkak të një keqpërdorimi të tillë është ndaluar edhe z. Ramush Haradinaj. Hoxhaj njoftoi se për këtë çështje ka vizituar Francën, jo vetëm për rastin e z. Haradinaj në raport me Francën, por edhe të tematizohet në një shtet të fuqishëm se Serbia po e keqpërdor Interpolin për qëllimet e saja politike.

Sa i përket çështjes së trenit, ministri Hoxhaj njoftoi se MPJ-ja katër javë më herët ka pas informata dhe ka dal me solucione të cilat merren me çështje të brendshme, me sundim të ligjit si dhe kanë pasur skenarë të qartë se si do të duhej të sillen në raport me trenin. Atë ditë kur është marr vendimi që të ndalohet treni, ministri njoftoi se skenarët kanë qenë të menduar dhe të debatuar mirë, si dhe është bërë përpjekje që në një shkresë të detajuar të informohen 49 shtete të ndryshme, për atë se çfarë ka ndodh. Ministri Hoxhaj njoftoi se në analizën e bërë nga MPJ-ja, një sjellje e tillë e Serbisë shihet edhe në raport me vendet tjera të rajonit, ka pasur kërcënime ndaj Kroacisë para se të ndodh hapja e kaptinave në rrugën evropiane të Serbisë gjatë vitit të kaluar. Vitin e kaluar është mbajtur një referendum në Banjallukë, prapa të cilit qëndron Republika e Serbisë dhe se me 9 janar ka pas për herë të parë festime të ditës së republikës serbe në Banjallukë me marshim të forcave të armatosura, duke shkelur marrëveshjen e Dejtonit, tha Hoxhaj

Ai po ashtu, foli për tentim puçin në Mal të Zi, ku në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve ka pas përfshirje të zyrtarëve të policisë të shtetit serb. Acarimi i gjuhës dhe përdorimi i një diskursi agresiv dhe provokues në raport me Maqedoninë, ku në mënyrë sistematike ministri i jashtëm serb thotë se nuk do të duhej të njihet Maqedonia me emrin e saj kushtetues. Të gjitha këto reflektojnë për një politikë agresive të Serbisë në raport me Maqedoninë, njoftoi ministri Hoxhaj.

Shqetësim tjetër që ngriti ministri Hoxhaj është tendenca permanente e rritjes së potencialit ushtarak të Serbisë, duke u ndërlidhur me vizitat e Kryeministrit Vuçiq në dhjetor të vitit 2016 dhe janar të vitit 2017, me marrëveshjet e arritura për blerjen e mjeteve ushtarake dhe shtoi se bilanci rajonal nuk është i njëjti çfarë ka qenë para tre muajsh. Ministri tha se Kosova është duke ndjekur një politikë të kujdesshme në raport me Serbinë, se dialogu është një instrument i politikës së jashtme, por Kosova duhet ta ndërtojë një politikë më të gjerë se si t’i qaset Serbisë në vitet e ardhshme.

Ministri në fund shtoi se deri sa të caktohet data e zgjedhjeve në Serbi, Qeveria e Kosovës i mendon skenarët më të mirë, por gjithashtu e kanë për obligim që të mendojnë për skenarët e ri provokues dhe për çdo situatë do të jenë në dispozicion.

Elmi Reçica, tha se duke i analizuar ndodhitë e muajve të fundit, shihet se këto nuk janë vetëm provokime, por është një strategji e Serbisë, mirëpo, ne jemi në një situatë që e dimë saktësisht që Serbia ka plane dhe projekte që janë në dëm të Kosovës dhe që e destabilizojnë gjithë rajonin. Serbia, tha Reçica, aktualisht i dëshiron paratë dhe integrimet Evropiane, ndërsa armët i kërkon nga Rusia dhe Bjellorusia dhe ky është rreziku më i madh. Komisioni për Punë të Jashtme dhe Ministria e Punëve të Jashtme duhet ta kenë një koordinim për këto politika, theksoi Reçica.

Pal Lekaj, lidhur me çështjen e z. Ramush Haradinaj, shprehu mendimin se Serbia është duke vepruar në drejtim të ekstradimit të z. Haradinaj në Beograd. Ai po ashtu njoftoi se Serbia ka dërguar material voluminoz pa argumente dhe se Qeveria e Kosovës ka kontaktuar me zyrtarët e lartë të shtetit francez prej momentit të ndalimit të z. Haradinaj. Sa i përket dokumentacionit, Lekaj tha se nuk kemi ndonjë informatë se çfarë përmban ai dokumentacion, dhe pyeti se si mund të lejohet që shteti i Serbisë të krijojë materiale apo vendime politike për një qytetar të Kosovës. Lidhur me këtë shprehu mendimin se kjo është një ndërhyrje e drejtpërdrejtë në sovranitetin e Kosovës, se Serbia nuk ka të drejtë të merret me krijimin e aktakuzave apo padive ndaj qytetarëve të Kosovës. Qeveria e Kosovës është dashur ta nxjerrë një deklaratë që të mos pranohet ai material, sepse është politik. Sa i përket veprimeve të dëmshme të Serbisë ndaj Kosovës pyeti se çfarë do të thotë kjo për Ministrin e Jashtëm dhe çka fshihet prapa kësaj.

Lidhur me trenin, Lekaj tha se treni nuk ka hyrë në Kosovë, por ishte një atak që tentoi Serbia ta kryej mbi sovranitetin e shtetit të Kosovës. Disbalanci i armatimit në rajon tha se duhet të jetë shqetësues dhe se duhet të parandalohet. Lidhur me këtë pyeti ministrin se cilat janë veprimet e Qeverisë së Kosovës, kur dihet që Kosova ende nuk ka ushtri dhe çfarë janë veprimet e Qeverisë së Kosovës në rast se Serbia pretendon me këto veprime ta destabilizojë apo të ridizajnojë territorin e Kosovës.

Sa i përket listave të Interpolit, Lekaj tha se është për të ardhur keq që Serbia abuzon me listat e Interpolit dhe pyeti ministrin se a është komunikuar me shtetet siç janë Shqipëria dhe Kroacia dhe si do të bashkërendohen veprimet me këto shtete, në drejtim të pastrimit të listave të Interpolit.

Pal Lekaj pyeti ministrin se a është në dijeni me materialin që e ka dërguar Serbia kundër z. Haradinaj, se a është marr dikush nga Qeveria me këto materiale dhe çka është bërë në këtë drejtim. Sa i takon materialit, tha se ai nuk duhet të merret për bazë, por të injorohet tërësisht, sepse z. Haradinaj nuk është qytetar i Serbisë, por është qytetar i Kosovës.

Zafir Berisha, tha se ministri nuk e ka potencuar qëndrimin e shtetit të Kosovës në raport me pretendimet dhe strategjinë destabilizuese të Serbisë. Serbia po vazhdon me politikën e saj armiqësore ndaj Kosovës, por ne nuk e dimë se si po sillet Kosova me një shtet armiqësor.

Sa i përket platformës së Vuçiçit, Berisha tha se është shqetësuese dhe pyeti se cila është platforma e Qeverisë së Kosovës që i kundërvihet Serbisë.

Lidhur me ndikimin e Ruisë në veri, tha se Rusia përmes organizatave joqeveritare ka shtuar ndikimin e vet dhe ka bërë një ekip paramilitar me mbi 500 persona në atë pjesë. Hyrjet ilegale po vazhdojnë, disa janë ndaluar dhe se ekzistojnë disa rrugë alternative, në të cilat institucionet e Kosovës nuk kanë qasje për shkak të strukturave ilegale dhe paralele kriminale të Serbisë. Për çështjen e fletarresteve, pyeti se çfarë është bërë në atë drejtim, kurse sa i përket murit ilegal pyeti se si ka mundësi që Qeveria e Kosovës për një projekt ilegal të bëjë marrëveshje politike.

Ismet Beqiri, tha se arrestimi i z. Haradinaj është i padrejtë, mirëpo, procedurat jo gjithherë varen nga ne, kurse angazhimi i Kosovës dhe i gjithë neve, nuk duhet të pushojë derisa z. Haradinaj të lirohet. Sa i përket çështjes së murit dhe trenit, Beqiri tha se është vepruar në mënyrë institucionale, është vepruar në mënyrë

të përgjegjshme, është mirë që janë ndërmarrë veprime shtetërore dhe është mbrojtur sovraniteti i vendit. Në situata të tensionuara, siç ka qenë rasti me murin, Beqiri tha se Serbia dhe një pjesë e qytetarëve serbë për të provokuar sillën ashtu siç nuk do të duhej dhe në situata të tilla është mirë që ata që e kanë marr vendimin për ndërtimin e murit, e kanë rrënuar atë. Sa i përket çështjes së murit, pavarësisht që është ndërmjetësuar me marrëveshje, e rëndësishme është ajo që është realizuar pa problem të madh dhe pa pasoja. Ky është veprim institucional i koordinimit në nivel qendror dhe lokal si dhe me përkrahjen nga miqtë tanë.

Qerim Bajrami, duke u ndërlidhur me çështjet e diskutuara, theksoi se veprimet e ndërmarra nga e ana e Serbisë janë të gjitha të planifikuara, duke filluar nga aksioni i ndërtimit të murit e deri tek burgosja e z. Haradinaj. Më tej tha se gjëja e cila direkt ndikon në realizmin e politikës në Parlament dhe pjesërisht në Qeveri, është ndikimi i drejtpërdrejtë në tërheqjen e përfaqësuesve të komunitetit serb nga sistemi institucional, si nga Kuvendi ashtu edhe nga Qeveria, që do të thotë se Serbia po ndikon drejtpërdrejtë në përfaqësuesit serbë.

Serbia ka ndikim edhe në Bosnje e Hercegovinë, dhe se ne i dimë qëndrimet e popullit boshnjak dhe kroat ndaj Kosovës, por për shkak të vetos nga ana serbe, të cilët janë në kryesi dhe për shkak të ministrit serb nuk mund të njihet pavarësia e Kosovës. Bajrami propozoi që të ndërmerren disa hapa në bashkëpunim me Shqipërinë që këtë bllokadë ta thyejnë, për krijimin e marrëdhënieve shqiptaro-boshnjake.

Luljeta Veselaj-Gutaj, tha se ministri ofroi shumë informacione, duke filluar nga vitet e hershme deri në zhvillimet e fundit dhe preokupimet e njëjta që i kemi si Komision janë edhe të ministrisë. Ajo shtoi se puna e ministrisë është për tu përgëzuar sepse është dëshmuar në dy muajt e fundit, sidomos në raportet e Kosovës me Serbinë, me rastin e z. Haradinaj, me rastin e murit si dhe me rastin e trenit.

Blerta Deliu-Kodra, lidhur me çështjen e ndërtimit të murit shprehu mendimin se, ka qenë një kontribut i përbashkët në mes të faktorit ndërkombëtarë dhe institucioneve vendore, të cilat kanë qenë të përgjegjshme dhe kanë marr përgjegjësi konform ligjit. Për dialogun me Serbinë, pyeti se a është duke ndikuar pozitivisht në normalizimin e marrëdhënieve, veçanërisht pas zhvillimeve të fundit; si shihet në të ardhmen ky dialog; çka duhet të diskutohet në fazën e re të dialogut; çfarë impakti ka pas dialogu në njohjen nga shtetet e tjera, në përfaqësimin ndërkombëtar të Kosovës si dhe në atë që është konsolidim i subjektivitetit ndërkombëtar të vendit.

Znj. Deliu-Kodra pyeti lidhur me anëtarësimin e Kosovës në organizata rajonale dhe ndërkombëtare, ku qëndron Kosova në këtë drejtim dhe a ka pasur aplikim për anëtarësim në organizata të ndryshme rajonale dhe ndërkombëtare. Si qëndron puna me fusnotën, pasi që Komisioni ka miratuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes për themelimin e Fondit të Ballkani Perëndimor, i cili ka ardhur me fusnotë. Lidhur me fusnotën, po ashtu, pyeti se a pritet që kjo fusnotë të largohet dhe se a ka pasur ndikim në lirim të Kosovës që të bëhet pjesë e mekanizmave ndërkombëtarë.

Znj. Deliu Kodra shprehu mendimin se Zyra Ndërlidhëse në Beograd, ka luajtur një rol të caktuar gjatë këtyre zhvillimeve dhe ka qenë një adresë që ka raportuar lidhur me zhvillimet që kanë ndodhur.

Për kalimet ilegale të zyrtarëve serbë, pyeti se a kryhet ndonjë verifikim i sigurisë për personat, të cilët duan të marrin leje për të hyrë në Kosovë, si merren këto leje dhe a ka Kosova lista të të dyshuarve për krime lufte. Znj.

Lidhur me Raportin e Fondit për të Drejtën Humanitare, pyeti se cilat janë vlerësimet e ministrit dhe se a ka pasur rast që këtë raport ta diskutojë me faktorin ndërkombëtar në Kosovë.

Elmi Reçica, tha se Komisioni e ka intensifikuar diplomacinë parlamentare dhe janë krijuar grupet e miqësisë, duke shtuar se ministri mund të llogaritet në mbështetjen e Komisionit në të gjitha proceset. Reçica njoftoi se në radhë të parë përfaqësojmë shtetin, pavarësisht se ku jemi dhe çfarë pune bëjmë dhe pastaj jemi koshient ndaj asaj që t'i lëvizim proceset përpara.

Enver Hoxhaj, njoftoi se ministria është në një situatë permanente të vëzhgimit të raporteve me Serbinë. Sa i përket z. Haradinaj, tha se është ofruar garanci shtetërore dhe po ashtu është ofruar çdo dokument i nevojshëm lidhur me këtë rast. Hoxhaj njoftoi se ka pasur tri telefonata me ministrin e jashtëm francez dhe ka realizuar vizitë në Francë, pas së cilës ka biseduar edhe me z. Haradinaj.

Sa i përket listave të Interpolit, tha se ato aktivizohen çdo vit dhe se është një betejë permanente aktivizimi dhe shfuqizimi i tyre.

Ndërtimi i shtëpive në “Luginën e Diellit” tha se është politikë destabilizuese e Serbisë dhe njoftoi se kanë komunikuar me disa shtete që janë përmend si financues të mundshëm dhe iu është thënë se financimi në këtë projekt është gabim.

Sa i përket ndarjes së territorit të Kosovës, Hoxhaj tha se nuk ka gjë më të dëmshme për Kosovën sesa përmendja e kësaj teme dhe shprehu mendimin se duhet të shihet mundësia se si shqiptarët që jetojnë në Luginë të Preshevës dhe në dy komunat tjera t’i kenë të drejtat e njëjta, dhe reciproke. Hoxhaj shtoi se projekti i ndarjes si zgjidhje politike është projekt i jetës politike serbe në 25 vitet e fundit, ndërsa detyra jonë është ta mbrojmë sovranitetin e Kosovës.

Sa i përket çështjes së trenit dhe të murit, tha se është dashtë të vendosën në një kontekst politik që të kuptohet drejt nga të tjerët. Dialogu tha se është një segment i politikës së jashtme dhe duhet të mendohet edhe për tema se si të sillemi në raport me Luginën e Preshevës dhe me të drejtat e shqiptarëve atje. Ai njoftoi se atë ditë kur është ndalë treni është dashtë të sigurohen dokumente dhe vendime prej autoriteteve të komunikacionit, është dashtë të informohemi nëse treni ka licencë për të hyrë në hekurudhat e Kosovës, se a është pjesë e sistemit ndërkombëtar të hekurudhave, kurse si ministër i jashtëm është dashtë me marrë vendim nëse ka zyrtarë të shteti serb në tren dhe që nuk kanë kërkuar leje për të hyrë në Kosovë.

Lidhur me çështjen e murit, Hoxhaj tha se ministri Ferat Shala ka bërë një punë të shkëlqyeshme, pasi që ka qenë punë dhe barrë e tij se si të largohet muri.

Ministri sa i përket raporteve Kosovë- Serbi, tha se Serbia po krijon probleme në raport me Kosovën, pastaj kinse ndihmon me i zgjidh ato probleme dhe pret të marrë mirënjohje nga faktori ndërkombëtar, kjo për ne është e papranueshme.

Sa i takon vizave me Bosnjën, ai tha se ka biseduar disa herë me ministrin e jashtëm boshnjak, nga i cili ka marr premtime që do të ndihmojë, por ka përshtypjen se ai më shumë bënë deklarata për mediat, sesa që ka vullnet për të ndihmuar. Ai njoftoi se kërkesa e ministrit të jashtëm boshnjak që BE-ja të ndërmjetësojë për heqjen e regjimit të vizave në mes të Kosovës dhe Bosnjës, për Brukselin është e papranueshme.

Në fazën e re të dialogut, tha se duhet të bisedohet për demarkimin e kufirit me Serbinë, duhet të largohet neni i parë i Kushtetutës serbe që e përmend Kosovën, duhet të shihet mundësia e përdorimit të dialogut si një platformë për tu anëtarësuar në OKB. Ai më tej shtoi se dialogu nuk ka penguar në njohjen e pavarësisë së Kosovës nga shtetet tjera, dhe njoftoi se prej vitit 2011 Kosovën e kanë njohur 40-45 shtete.

Lidhur me përdorimin e asteriksit, Hoxhaj tha se sipas marrëveshjes për përdorimin e asteriksit, ai vlen vetëm në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe në Evropën juglindore dhe nëse vendoset kudo tjetër është e papranueshme.

Ministri Hoxhaj kërkoi nga anëtarët e Komisionit që votojnë për Fondin e Ballkanit Perëndimor, meqë ai me seli do të jetë në Shqipëri. Ai po ashtu tha se verifikimi i personave të cilët hyjnë në Kosovë bëhet në bashkëpunim me Policinë e Kosovës. Raporti i Fondit për të Drejtën Humanitare, tha se i është dërguar 130 shteteve.

Elmi Reçica, tha se raportet Kosovë-Serbi janë përcaktuese jo vetëm për ne, por edhe për rajonin dhe se çdo acarim, çdo konflikt dhe çdo marrëveshje ka ndikim të fuqishëm. Reçica tha se kemi hyrë në dialog dhe kemi dëshmuar që jemi partnerë të sigurtë dhe jemi shtet që iu përmbahet marrëveshjeve ndërkombëtare dhe i cili e mbron sovranitetin e vendit. Çështja e trenit dhe e ndodhive tjera e kanë zhveshur nomenklaturën e tashme serbe. Në kuadër të këtyre zhvillimeve, duhet të insistojmë që me të

gjithë që jetojnë në Kosovë ta bëjmë sa ma shpejtë ushtrinë e Kosovës dhe është e domosdoshme që serbët e Kosovës vendimet t'i marrin në Prishtinë dhe jo në Rashkë.

Pal Lekaj, informoi për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Protokollin e Shtetit, duke shtuar se janë realizuar disa vizita dhe është e nevojshme që të amendamentohet ligji, sepse ka ankesa nga shumica e të angazhuarve në sektorët e protokollit të shtetit.

Qerim Bajrami, kërkoi që në Samitin e kryetarëve të komisioneve të jashtme të ftohet një deputet boshnjak dhe një kroat nga Parlamenti i Bosnjës. Ai, po ashtu, propozoi që një pjese e samitit t'i kushtohet raporteve në mes Kosovës dhe Bosnjës.

Mbledhja përfundoi në orën 16:15.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Elmi Reçica